



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1236/22

GJYKATA KOMERCIALE - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përbarimore të kreditorit T...” Sh.p.k, me seli ne Prizren, ndaj debitorit “S...” shpk me seli ne Prizren, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit te ushtruar përmes përfaqësuesit te tij av. V.O, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore ne Prizren PPP.nr.137/21 te datës 08.12.2021, me datën 26.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit S...” shpk me seli në Prizren, **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.137/21 te datës 08.12.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.137/21 te datës 08.12.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit S...” shpk me seli ne Prizren, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.824/21 te datës 12.05.2021 të Përbaruesit privat Enis Hoxha nga Prizreni ndërsa urdhri për përbarim mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori përmes përfaqësuesit te tij av. V.O, për shkak te shkeljeve thelbësore te dispozitave te procedurës përbarimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe urdhrin për përbarim ta lë jashtë fuqie juridike ndërsa çështjen ta kthej në shkallë te parë për rivendosje.

Përgjigje ne ankesë ka paraqitur kreditori duke pretenduar qe nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori ne ankesën e tij sepse ne momentin e dhënies dhe pranimit te mjeteve ne emër te paradhënies do te evidentohet se për cilin projekt apo punë juridike jepet dhe se kreditori i përbarimit pranon se nga detyrimi total i debitorit sipas faturave me te cilat është iniciuar

procedura përmbaremore debitori ka paguar pjesërisht detyrimin duke mbetur në detyrim shumën prej 25432 euro. Fatura rrjedh nga situata II e muajit Gushtë 2018 për kryerjen e punëve ndërtimore në objektet banesore –afariste dhe si e tillë kjo faturë nuk mund të jetë fiktive dhe njëherit propozon që gjykata e shkallës së parë ta refuzoj ankesën si të pabazuar ndërsa aktvendimin e gjykatës e shkallës së parë ta vërtetoj. Propozon që Gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën e debitorit dhe ta vërtetoj aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbareim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave me nr.10 të datës 31.08.2018 dhe nr.6 të datës 18.04.2019.

Përmbareuesi privat Enis Hoxha nga Prizreni, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbareimor P.nr.824/2021 të datës 12.05.2021, ka lejuar përmbareimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën prej 25,432.04 euro me kamatë vjetore prej 8 % nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbareim.

Kundër urdhrin përmbareimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 24.05.2021, me pretendimin se urdhri për përmbareim është marrë në kundërshtim me nenin 71 nenpar.1.7 të LPP, se faturat nr.6 dhe 10 të datave 31.08.2018 dhe 18.04.2019 nuk janë dokumente ligjore që mund të jenë bazë për inicim të procedurës përmbareimore, nuk kanë tipare të përmbareueshmërisë, nuk janë të pranuar, të nënshkruara, dhe nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme. Me tej shton se kreditorit i ka bërë pagesa, para të gatshme me datat 15.03.2017, 22.05.2017, 24.06.2017 dhe 14.12.2017 në shumën prej 10 600 euro si avans, duke ritheksuar se faturat e lartcekura janë jo ligjore dhe si të tilla nuk kanëtribute të dokumentit të besueshëm, propozon që gjykata të pranoj prapësimin, ta prish urdhrin për përmbareim.

Përgjigje në prapësim ka bërë kreditori me datën 26.05.2021 me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori sepse faturat numër 10 dhe 6 i plotësojnë të gjitha kushtet për tu konsideruar dokumente të besueshme. Debitori ka pranuar, nënshkruar dhe vëlosur detyrimin që rrjedh nga situacioni ... me çka ka pranuar punimet e kryera nga debitori dhe detyrimin që rrjedh nga ky situacion andaj edhe faturat dhe detyrimi në këtë lëndë përmbareimore rrjedh nga ky situacion, ka pranuar faturat. Sa i përket avansit kreditori arsyeton se në fletëdërgesa nuk precizohet qartë saktë se për cilin projekt është paguar avansi pasi sipas LMD dhe moralit afarist

duhet te ceket puna për te cilën paguhet avansi. Propozon që te refuzohet si i pabazuar prapësimi dhe te mbetet në fuqi urdhri për përmbarim i përmbaruesit privat Enis Hoxha.

Gjykata Themelore në Prizren, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerr aktvendim PPP.nr.137/21 të datës 08.12.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar së urdhri për lejimin e përmbarimit është lëshuar në bazë të faturave nr.6 dhe 10 të cilat rrjedhin nga situacionin të datës 31.08.2018, të cilat janë dokument i besueshëm në rastin konkret pasi në to janë treguar palët në procedurë, objekti, mjete, shumat e detyrimit në të holla dhe koha e saktë e përmbushjes, pra i përmbajnë të gjitha të dhënat të cilat duhet të kenë dokumentet e besueshme. Arsyeton se sipas gjendjes së shkresave në lëndë rrjedh se debitori ka nënshkruar dhe ka qenë në dijeni për detyrimin e tij dhe atë sipas marrëveshjes –situata 03/SP-2018 të datës 31.08.2018 për punët e kryera, pala debitorë pjesërisht e ka kryer një pjesë të detyrimit në të holla. Vlerëson se prapësimin të saj nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme nga të cilat do të aprovohej i njëjti, ashtu që nuk ka kushte të parapara nga neni 71 i LPP të cilat do ta pengonin zbatimin e përmbarimit në këtë çështje juridike.

Gjykata e Komerciale -Dhoma e Shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit, 29 paragrafi 1 pika 1.3, e lidhur me nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se me dispozitën e nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së përcaktohet se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimin të pranohet nga gjykata”.*

Në këtë kontekst, përveç të cekurave më lart, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dështuar që në pjesën e arsyetimit të japë arsyeje lidhur me atë se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarimi, a i plotësojnë kushtet si dokumente të besueshme dhe se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me atë se faturat derivojnë nga situacioni nr.03/SP-2018 dt.31.08.2018, për këtë gjykatë është tërësisht i pabazuar, pasi që nga shkresat e lëndës shihet qartë

se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarimi janë të panënshkruara nga ana e debitorit, ashtu që mbetet të shihet se a i plotësojnë kushtet për tu konsideruar dokumente të besueshme konform dispozitave ligjore. Po ashtu edhe sa i përket avansit të cilin pretendon debitori se i ka paguar kreditorit në një shumë prej 10600 euro dhe të cilat pretendon se i ka marrë kreditori, nuk është analizuar dhe vlerësuar në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me rastin e vendosjes lidhur me prapësimin.

Në këtë kontekst Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë fare arsytim lidhur me atë se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarimi a janë lëshuar për punët të cilat supozohet se janë kryer, a janë lëshuar në kuadër të kontratës kryesore pasi faturat janë të panënshkruara nga debitori dhe të papranuara nga i njëjti. Po ashtu mbetet të sqarohet nga gjykata e shkallës së parë pretendimi i debitorit për pagesat si avans, si në fletë dërgesat në lëndë, sepse është e paqartë për gjykatën e shkallës së dytë se këto pagesa për cilin projekt janë bërë dhe a janë pranuar, andaj edhe nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të shqyrtoj prapësimin duke caktuar seancë dëgjimore në kuptim të dispozitave të lartcekura, në atë mënyrë që të ftohen palët ndërgjyqëse në seancë, ashtu që të njëjtat të deklarohen rreth pretendimeve të tyre, duke ofruar prova materiale lidhur me këtë e më pastaj duke vlerësuar edhe shkaqet ligjore nga neni 71 të LPP-së, dhe varësisht nga të gjeturat edhe të vendos.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË,
DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.1236/22, me datë 26.09.2022**

Gjyqtari,
Faton Bajrami